

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE
INFORMALE, QARKU VLORË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë Qendrore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Tiranë me objekt: “mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale” për periudhën 01/01/2008-31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH nr. 92, datë 25/6/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01/6/2000, me shkresën nr. 181/14, datë 25/6/2012 dërguar z. **Sami SELFO**, Drejtor i ALUIZNI Qarku Vlorë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. T’i kërkohet Ministrin të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, që për objektet e pajisura me leje legalizimi në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar, për shfuqizimin e lejeve të legalizimit sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

2. Të bëhet inventarizimi i të gjithave dosjeve përkatëse të ndërtimeve informale, dhe kalimi i dosjeve nga sektori në sektor të bëhet me procesverbal, të administruar me numër protokollit dhe inventar.

Menjëherë

3. Të rakordohet dhe të plotësohet sistemi digjital me vetëdeklarimet e pa hedhura nga sistemi manual për 1,329 raste (dosje)

Menjëherë

4. Në bazë të dokumentacionit që disponohet dhe të korrespondencës me NJ.Q.V, institucionet dhe subjekte të ndryshëm, të bëhet azhurnimi i studimeve urbanistike pjesore në zbatim të procesit të legalizimit.

Vazhdimisht

5. Të plotësohen me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, të gjitha dosjet përkatëse të ndërtimeve informale.

Menjëherë

6. Për të gjitha praktikat të përcaktohet në genplan, hyrja në parcelën ndërtimore, në zbatim të pikës 1.3, të urdhrin nr. 291, datë 01.09.2008 “Për miratimin e manualit “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të objektit që legalizohet”.

Menjëherë

7. Në dosjen nr. 1322/5, datë 17.03.2005 dhe dosjen nr. 454/4, datë 15.03.2005, të vendosen në genplanet përkatëse, objektet e dyta të paraqitura në ortofoto digjitale si dhe të vepohet në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar.

Menjëherë

8. Për objektin e pa identifikuar në ortofoto digjitale, me vetëdeklarimin nr. 2070/2, datë 31.06.2006, të vepohet në zbatim të neneve 2 dhe 4 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar dhe VKM nr. 437, datë 28.06.2006.

Menjëherë

9. Për dosjet nr. 998/2, nr. 2343/2 dhe nr. 999/2, të bëhet korigjimi i kontratave të kalimit të truallit në pronësi dhe të vepohet për pezullimin e procedurave për dhënie leje legalizimi në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, të ndryshuar.

Menjëherë

10. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë, të ndryshohet numri i pasurisë nga 5/12 në pasurinë nr. 1/37, që i përket dosjes nr. 904/2, datë 20.03.2005, trajtuar në faqet 31-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

11. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë, në rrugë administrative të inicohet me individët për korigjimin e kontratave të shitjes së truallit të poseduesve të ndërtimeve informale, të lidhura si më poshtë:

a. Kontratën e lidhur në kundërshtim me VKM nr. 286, datë 18.03.2008 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale“, me nr. 1564/1263, datë 01.09.2009.

b. Kontratat e lidhura në kundërshtim me VKM nr. 1657, datë 24.12.2008 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale“, si më poshtë:

- nr. 802/755, datë 20.06.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 128.80 m^2 ;
- nr. 486/448, datë 30.03.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 200 m^2 ;
- nr. 902/489, datë 17.06.2010, shitur më pak truall me sipërfaqe 78 m^2 ;
- nr. 633/590, datë 14.04.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 200 m^2 .

c. Kontratat e lidhura në kundërshtim me VKM nr. 1481, datë 12.11.2008 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale“, si më poshtë:

- nr. 462/424, datë 30.03.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 200 m^2 ;
- nr. 484/446, datë 30.03.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 48 m^2 ;
- nr. 1442/1342, datë 30.11.2010, shitur më pak truall me sipërfaqe 31 m^2 ;
- nr. 3420/4, datë 24.10.2006, shitur më pak truall me sipërfaqe 200 m^2 ;
- nr. 410/348, datë 08.04.2011, shitur më pak truall me sipërfaqe 722 m^2 .

d. Kontratën e lidhur në kundërshtim me VKM nr. 100, datë 27.01.2009 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale“, me nr. 775/729, datë 18.06.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 50 m^2 .

- e. Kontratën e lidhur në kundërshtim me VKM nr. 247, datë 13.04.2010 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale”, me nr. 163/159, datë 09.02.2011, shitur më pak truall me sipërfaqe 300 m².
- ë. Kontratën e lidhur në kundërshtim me VKM nr. 450, datë 06.05.2009 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale”, me nr. 2124/1629, datë 14.12.2009, shitur më pak truall me sipërfaqe 200 m².
- f. Kontratën e lidhur në kundërshtim me VKM nr. 805, datë 22.07.2009 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale”, me nr. 722/684, datë 17.05.2010, shitur më pak truall me sipërfaqe 98 m².
- g. Kontratën e lidhur në kundërshtim me VKM nr. 677, datë 18.06.2009 “Për kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale”, me nr. 479/399, datë 12.05.2010, shitur më pak truall me sipërfaqe 200 m².

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë, t’u kërkohet subjekteve në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit të shkaktuar në 29 raste, **në shumën 35,558,101 lekë**, si më poshtë:

a. Në 9 raste arkëtuar më pak **425,815 lekë** nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në dosjet konkretisht si më poshtë:

- në dosjen nr. 454/4 arkëtuar më pak **1,405 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 1475/4, arkëtuar më pak **93,837 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 2895/4, arkëtuar më pak **1,243 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr.1607, arkëtuar më pak **109,551 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 561/4, arkëtuar më pak **417 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 168/2, arkëtuar më pak **44,461 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 431/5, arkëtuar më pak **5,660 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 894/4, arkëtuar më pak **169,154 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

- në dosjen nr. 2676/2, arkëtuar më pak **87 lekë**, nga taksa e ndikimit në infrastrukturë,.

b. Në 17 raste arkëtuar më pak **35,116,286 lekë** si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore të paguar, me sipërfaqen e vëtedeklaruar të përcaktuar në VKM dhe që zotëron poseduesi i ndërtimit informal në fakt, sipas dosjeve konkretisht;

- në dosjen nr. 904/2, arkëtuar më pak **2,997,000 lekë**;

- në dosjen nr. 1187/5, arkëtuar më pak **1,288,000 lekë**;

- në dosjen nr. 1475/4, arkëtuar më pak **2,000,000 lekë**;

- në dosjen nr. 2895/4, arkëtuar më pak **480,000 lekë**;

- në dosjen nr. 561/4, arkëtuar më pak **2,000,000 lekë**;

- në dosjen nr. 663/4 arkëtuar më pak **310,000 lekë**;

- në dosjen nr. 1528/5 arkëtuar më pak **500,000 lekë**;
- në dosjen nr. 3420/4 arkëtuar më pak **2,000,000 lekë**;
- në dosjen nr. 1573 arkëtuar më pak **8,664,000 lekë**;
- në dosjen nr. 270/1, arkëtuar më pak **3,000,000 lekë**;
- në dosjen nr. 271/4, arkëtuar më pak **2,000,000 lekë**;
- në dosjen nr. 431/5, arkëtuar më pak **820,000 lekë**;
- në dosjen nr. 803/5, arkëtuar më pak **780,000 lekë**;
- në dosjen nr. 894/4, arkëtuar më pak **1,161,179 lekë**;
- në dosjen nr. 723/4, arkëtuar më pak **2,000,000 lekë**;
- në dosjen nr. 275/2, arkëtuar më pak **2,400,000 lekë**;
- në dosjen nr. 1607, arkëtuar më pak **2,716,107 lekë**.

c. Në 3 raste arkëtuar më pak **16,000 lekë**, tarifë shërbimi, në dosjet me nr. 1475/4, dhe nr. 2676/2.

Menjëherë

2. Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë, të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga pagesat e tepërta të qirasë, të zyrave të marra më qira nga subjekti ■■■■■, në shumën **46,760 lekë**.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-it, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

I. “Zgjidhjen e kontratës së punës”

1. **Për z. ■■■■■** me detyrë specialist në sektorin e Hartografisë dhe me cilësinë e ish-Përgjegjës të Sektorit të Legalizimit të Ndërtimeve Informale e Urbanizimit:

- Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe në përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti tek posedues i ndërtimit pa leje, veprime në kundërshtim me:

- ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“ nenet 2, 17, 19, 20 23, 27,29 dhe 30;

- ligjin nr. 9154, datë 06,11.2003 “Për arkivat”;

-VKM nr. 437, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”;

- VKM nr. 438 datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”;

- VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” dhe

-VKM nr. 411, datë 19.5.2010.

a. Për dosjet e pajisura me leje legalizimi, në 47 raste dhe konkretisht:

- në 31 raste në studim urbanistik dhe në rrugë, në dosjet nr. 2366/4, nr. 2283/4, nr. 2692/2, nr. 1121/4, nr. 1793/4, nr. 408/4, nr. 918/4, nr. 2479/4, nr. 1451/4, nr. 1830/4, nr. 3440/4, nr. 1913/4, nr. 1123/4, nr. 2453/4, nr. 430/4, nr. 2283/4, nr. 2546/2, nr. 2045/4, nr. 1007/4, nr. 1083, nr. 2369, nr. 918/4, nr. 410/4, nr. 412/4, nr. 681/4, nr. 1827/4, nr. 494/4, nr. 1837/4, nr. 2786/4, nr. 1812/4 dhe nr. 1808/4.

- në 1 rast mbi kolektor, dosja nr. 1569/4,

- në 4 raste në studim urbanistik, në zona të gjelbëria dhe në rrugë, në dosjet nr. 132/4, nr. 3590/4 dhe nr. 2591/4, nr. 709/3,

- në 10 raste në studim urbanistik 6-8-10 kat (nga të cilat 4 raste edhe me pronar), në dosjet nr. 704/2, nr. 2629/2, nr. 2546/2, nr. 89/2,1, nr. 89/2,2, nr. 88/2, nr. 442/3, nr. 2366/4, nr. 130/4 dhe nr. 1191/2.

- në 1 rast rrugë kombëtare, dosja nr. 1199.

b. Ka lejuar parregullsi në plotësimin e dosjeve dhe ka vazhduar procedurën duke i kualifikuar, në 18 raste, konkretisht dosjet me nr. 454/4, nr. 2676/2, nr. 2895/4, nr. 1607, nr. 561/4, nr. 2405/4, nr. 663/4, nr. 1528/5, nr. 3420/4, nr. 2745/4, nr. 97/3, nr. 2070/2, nr. 803/5, nr. 894/4, nr. 723/4, nr. 275/2, dhe 89/2,1.

II. “Vërejtje me paralajmërim për Zgjidhjen e kontratës së punës”.

1. **z.** [redacted] me detyrë përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.

2. **z.** [redacted] me detyrë , përgjegjës i Sektorit të GIS-t.

3. **zj.** [redacted] me detyrë përgjegjës i Sektorit të Legalizimit të Ndërtimeve Informale e Urbanizimit.

- Për të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe në përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti tek posedues i ndërtimit pa leje.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“ nenet 2, 17, 19, 20 23, 27, 29 dhe 30, ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, VKM nr. 437, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”, VKM nr. 438 datë 28.06.2006. “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” dhe VKM nr. 411, datë 19.5.2010 janë miratuar leje legalizimi:

III. Për të meta dhe mangësitë e konstatuara të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për ish-punonjësit: z. [redacted], zj. [redacted], z. [redacted], z. [redacted], zj. [redacted], z. [redacted], z. [redacted], z. [redacted], zj. [redacted], zj. L.V., z. [redacted] dhe zj. [redacted] dhënia e masave disiplinore quhet e ezauruar. Këta punonjës kanë një periudhë kohore mbi 1 vit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, në zbatim të kontratave individuale të lidhura sipas Kodit të Punës, dhe shkeljet e konstatuara janë të nivelit të dhënies së masave disiplinore.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale kërkojmë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, fillimin e procedimit penal për konsumimin e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 “*shpërdorimi i detyrës*”, i Kodit Penal, kryer nga persona që ushtrojnë e kanë ushtruar funksione publike në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, në ngarkim të:

1. **Për z. ■■■** me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, për shkeljet e mëposhtme:

2. **Për z. ■■■** me detyrë specialist në sektorin e Hartografisë dhe me cilësinë e ish-Përgjegjës të Sektorit të Legalizimit të Ndërtimeve Informale e Urbanizimit.

Për shkelje në kundërshtim me nenet 2, 17, 19, 20, 23, 27, 29 dhe 30 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, VKM nr. 437, datë 28.6.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”, VKM nr. 438, datë 28.06.2006. “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit” dhe VKM nr. 411, datë 19.5.2010.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Artan Mirashi, Qemal Shehu, Pal Daçi dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj dhe Drejtori Juridik dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT